

**UDHËZIM**  
**Nr. 22, datë 15.10.2021**

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 16, DATË 3.4.2020, “PËR FATURËN  
DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT”**

Në mbështetje të nenit 102, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 47, të ligjit nr. 87/2019, datë 18.12.2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

**UDHËZON**

Neni 1

Pika 2, e nenit 8 “Momenti i lëshimit të faturës”, të udhëzimit nr. 16, datë 3.4.2020, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, riformulohet si më poshtë vijon:

“2. Për furnizime në rastin e telekomunikacionit, transmetimit dhe shërbimeve elektronike për persona të patatueshëm, që kanë adresën e tyre të përhershme ose banojnë në Republikën e Shqipërisë, sipas nenit 29, të ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”, furnizuesi i huaj, nëpërmjet përfaqësuesit të tij tatimor në Republikën e Shqipërisë, lëshon fatura dhe zbaton procedurën e fiskalizimit, në përputhje me ligjin, në momentin e furnizimit, ose mund të lëshojë një faturë periodike jo më vonë se data 10 e muajit që pason muajin në të cilin janë dhënë shërbimet.”

Neni 2

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË  
**Delina Ibrahimaj**